

# 10 vjet këshillim telefonik për fëmijët në Shqipëri!

unicef   
for every child



## RAPORT

TË DHËNAT E TELEFONATAVE DHE TË RASTEVE  
TË FEMIJËVE NË SHQIPËRI

2016

Tiranë, Prill 2016

**Titulli “Raport i të dhënave dhe i Rasteve të Linjës Kombëtare të Këshillimit për Fëmijë, Alo 116”**

**Përgatitur nga:**

**Prof. Dr. Edlira Haxhiymeri**

**Me asistencën e:**

Znj. Marsela Allmuça  
Z. Mirgit Vataj  
Znj. Erinda Ibrahimllari

Ky Raport, është mundësuar me mbështetjen financiare të zyrës së UNICEF në Shqipëri.

Përmbajta e tij është përgjegjësia e vetme e ALO 116. Opinionet e shprehura në të jo domosdoshmërisht përfaqësojnë opinionet e ALO 116 apo ato të donatorit.

**Për informacione të mëtejshme mund të kontaktoni me:**

**ALO 116 – Linja Kombëtare e Telefonit të Fëmijëve në Shqipëri**

Adresa Postare: Kutia Postare 1738, Tirana / Albania

Adresa e Zyrës: Rr. Perlat Rexhepi, Pallati ANA, Ap. 18, Kati 7, Tirane

Tel i zyrës: + 35542265741

E-mail: [alo116@alo116.al](mailto:alo116@alo116.al)

[www.alo116.al](http://www.alo116.al)

# PËRMBAJTJA

## 1. Hyrje

## 2. Shpërndarja e telefonatave sipas kategorive

- Kategorizimi i përgjithshëm i telefonatave
- Raste të trajtuara nga ALO 116
- Referimet tek shërbimet e tjera
- Telefonata të ndara sipas prurjes
- Telefonata sipas shpërndarjes gjeografike
- Moshë dhe gjinia e telefonuesve
- Rezidenca e fëmijës
- Telefonata për Informacion
- Telefonata Psiko-edukuese
- Telefonata Testuese

## 3. Kategorizimi i rasteve sipas çështjeve të raportuara

- Abuzimi dhe dhuna
- Shfrytëzim i fëmijës
- Marrëdhëniet me bashkëmoshatarët
- Probleme në shkollë
- Çështje ligjore
- Përdorim dhe abuzim me substanca
- Fëmijë me aftësi të veçanta
- Seksualiteti
- Marrëdhëniet familjare
- Shëndeti mendor
- Siguria në internet

## 4. Konkluzione

## 5. Rekomandime

## LISTA E SHKURTIMEVE

**ASHMDF**

**Agjensia Shtetërore për Mbrojtjen e Fëmijëve**

<b>SHSSH</b>	Shërbimi Social Shtetëror
<b>NJMF</b>	Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve
<b>NJQV</b>	Njësi e Qeverisjes Vendore
<b>NJA</b>	Njësi Administrative
<b>DAR</b>	Drejtoria Arsimore Rajonale
<b>ZA</b>	Zyrë Arsimore
<b>OJF</b>	Organizata jo fitimprurëse
<b>PAK</b>	Persona me Aftësi të Kufizuara

# 1. HYRJE

Sipas Unicef në vëndin tonë janë rreth 1,000,000 fëmijë dhe ku një pjesë e konsiderueshme e fëmijëve vazhdojnë të përballen me problematika të cilat ndikojnë zhvillimin normal të tyre. Disa nga problematikat e fëmijëve shqiptarë sot lidhen me pabarazinë në rritje, përjashtimi social dhe diskriminimin, dhunën, abuzimin, shfrytëzimin, neglizhencën, dhunën në familje, Aksesin në shërbime cilësore (Shëndetësi dhe Arsim), Kequshqyerja, etj.<sup>1</sup> Problematikat dhe nevoja këto të cilat kanë nevojë për ndërhyrje të koordinuara dhe të gjithanëshme, ku Linja Kombëtare e Telefonit për Fëmijë shpeshherë është kontakti i parë për të adresuar këto problematika nga vetë fëmijët, familjarët apo edhe profesionistë të tjerë të fushës.

ALO 116 është një shërbim falas këshillimi dhe referimi për fëmijët i cili komunikon me fëmijët nëpërmjet numrave: 116 111 – Linja Kombëtare e Këshillimit për Fëmijë; ALO 116 000 – Linja Kombëtare e Telefonit për Fëmijët e Humbur dhe mbështetet nga zyra e UNICEF-Shqipëri dhe nga Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri (CRCA Shqipëri).

Linja Kombëtare e Telefonit për Fëmijë është një instrument që ka për qëllim të këshillojë fëmijët përmes telefonit dhe të referojë nevojat e tyre në institucionet përkatëse ku filozofia e Alo 116 është të përfshijë fëmijët në referimin e nevojave dhe problematikave që ata i shqetësojnë dhe t'i ndërgjegjësojë ata për të drejtat e tyre. Shërbimet e linjës synojnë të kontribuojnë në përmirësimin e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve nëpërmjet avokatësisë dhe mbështetjes së një sistemi që i përgjigjet fëmijëve që kanë nevojë për kujdes dhe mbrojtje.

ALO 116 është një mundësi për çdo fëmijë që të ndihmohet në një moment të vështirë të jetës së tij/saj, si edhe është një vend, ku e drejtat e çdo fëmije për t'u dëgjuar, për t'u shprehur, për t'u informuar dhe për të informuar mbi situatën e tij/saj respektohet dhe ai/ajo merr shërbimin e duhur, të ofruar nga një staf i kualifikuar.

Shërbimi përqëndrohet tek fëmijët në nevojë si: fëmijët e dhunuar, abuzuar apo keqtrajtuar, fëmijët e rrugës, fëmijët që shfrytëzohen në punë, fëmijët që janë në konflikt me ligjin etj. Ky shërbim përfshin dhe prindërit, mësuesit, edukatorët apo personat e interesuar për çështje lidhur me dhe për fëmijët.

---

<sup>1</sup> <https://www.unicef.org/albania/sq/children.html>

## Parimet e punës së Linjës Kombëtare të Telefonit për Fëmijë – ALO 116 janë:

- Përgjigja çdo telefonate 24 orë në 7 ditë të javës;
- Shërbim për fëmijët dhe të rinjtë në nivel kombëtar;
- Shërbimi i ofruar nga profesionistë psiko-socialë (psikologë dhe punonjës socialë) të cilët presin telefonatat e fëmijëve dhe i këshillojnë për problemet dhe shqetësimet e tyre;
- Ofrimi i këshillimit dhe ndihmës për çdo fëmijë;
- Ofrimi i standarteve më të mira të shërbimit për fëmijët dhe të rinjtë;
- Referimi i çdo rasti, që kërkon zgjidhje, pranë shërbimeve publike dhe private të mbrojtjes së fëmijës, etj.

## ALO 116- Linja Kombëtare e Këshillimit për Fëmijë është një shërbim për fëmijët i cili ofron:

- Këshillim Psikologjik;
- Informacion;
- Referim në shërbimet përkatëse sipas specifikës së rastit.

Në raportin e statistikor të Alo 116 për periudhën Janar – Dhjetor 2016, paraqiten dhe analizohen shpërndarja e telefonatave sipas kategorive, çështjet të cilat janë raportuar si edhe referimi i rasteve sipas nevojave të vlerësuara nga ekipi i ALO 116.

## Kategorizimi sipas intensitetit të telefonatave:

Në linjën kombëtare të telefonit për fëmijë Alo 116, telefonatat kategorizohen edhe në bazë të shpeshtësisë që një telefonues ka kryer. Ato ndahen në:


a) permanente; b) periodike; c) telefonata të reja dhe d) telefonata të pa identifikuar.

- Në telefonatat permanente grupohen ato biseda, të cilat vijnë nga telefonues, që marrin më tepër se një herë në ditë pranë Linjës së Këshillimit për Fëmijët.
- Si telefonata periodike klasifikohen bisedat që janë bërë më tepër se një herë dhe të cilat kanë hyrë në procesin e trajtimit.
- Telefonata të reja klasifikohen ato biseda të cilat marrin për herë të parë pranë Linjës.
- Telefonata të pa identifikuar, të cilat zënë dhe numrin më të madh të telefonatave, ku përfshihen ato biseda të cilat këshilluesit nuk arrijnë të identifikojnë nëse telefonuesi e ka për herë të parë që telefonon në linjë.

## 2. SHPËRNDARJA E TELEFONATAVE SIPAS KATEGORIVE

Në linjën kombëtare të telefonit për fëmijë Alo 116, numri total i telefonatave të analizuara ndër vite nga 2010-2016 është 521,389 ku pjesën më të madhe të këtyre telefonatave e zënë telefonatat nga grupmosha 13-15 vjeç që përkon edhe me periudhën e adoleshencës. Krahasuar me vitet e mëparshme ka një ulje të numrit të përgjithshëm të telefonatave pranë Alo 116 nga viti në vit, lidhur kjo edhe me faktin që numrin më të lartë të telefonatave vitet e mëparshme e zinin telefonatat për informacion dhe testim, ndërkohë që tashmë linja është një shërbim i njohur për publikun dhe telefonatat e marra janë telefonata të cilat dinë se çfarë të kërkojnë nga Alo 116.


Viti	Numri i telefonatave
2010	158,033
2011	138,153
2012	99,203
2013	53,519
2014	25,486
2015	20,000
2016	27,389
<b>Total</b>	<b>521,389</b>



Grafiku 2. Numri i telefonatave ndër vite 2010-2016

Referuar viti të fundit, gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2016 janë pritur në total 27,389 telefonata, nga të cilat 23 % e tyre janë telefonata për informacion, 9 % telefonata psiko-edukuese, 3 % telefonata për këshillim, 7 % telefonata të ndërprera, 45 % telefonata testuese dhe 13 % telefonata në të cilat telefonuesi nuk flet (heshtje). Më konkretisht si në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm:

Kategorizimi i telefonatave	Total
Telefonata për informacion	6413
Telefonata për Psiko- edukim	2345
Telefonata për këshillim	774
Telefonata të ndërprera	1943
Telefonata testuese	12383
Heshtje	3531
<b>Totali</b>	<b>27389</b>



Grafiku 1. Kategorizimi i përgjithshëm i telefonatave


## 2.1 Rastet e trajtuara nga ALO 116 gjatë 2016

Lidhur me rastet e trajtuara gjatë vitit 2016 në linjën kombëtare të këshillimit për fëmijë, një numër të lartë zënë rastet të cilat raportojnë problematika të marrëdhënieve mes njëri - tjetrit (bashkëmoshatarëve), të shfrytëzimit për arsye përfitimi, marrëdhëniet familjare, problematikat në shkollë, siguria në internet, etj dhe në nivele më të ulëta çështjet të cilat lidhen me çështjet ligjore, diskriminimi, shëndeti fizik dhe çështjet e aftësive të veçanta. Më konkretisht, rastet e trajtuara sipas tematikës paraqiten në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm:

Abuzim dhe dhunë	<b>64</b>
Shfrytëzim për arsye përfitimi	118
Fëmijë me nevoja bazë	32
HIV-AIDS	0
Marrëdhëniet mes njëri-tjetrit	244



Probleme në shkollë	62
Çështje ligjore	3
Përdorim dhe abuzim me substanca	32
Fëmijë me aftësi të vecanta	8
Seksualiteti	20
Marrëdhëniet familjare	78
Shëndet mendor/psikosocial	37
Shëndet Fizik	5
Diskriminimi	3
Siguria në internet dhe celular	68
<b>Total</b>	<b>774</b>




Grafiku 3. Raste të trajtuara nga ALO 116

## 2.2 Referimet tek shërbimet e specializuara

Telefonatat për referim zënë një numër të rëndësishëm në ALO 116, ku klasifikohen ato telefonata të cilat kërkojnë ofrimin e shërbimeve specifike. Përgjatë 2016 numri total i referimeve është 178. Të gjitha këto janë raste të cilat janë referuar për shërbime specifike në institucione si policia e rendit 29 raste, Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve (NJMF) 45 raste, Agjensia shtetërore për mbrojtje e të drejtave të fëmijëve 45 raste, skuadrat e terrenit për fëmijët në situatë rruge, OJF të ndryshme 6 raste dhe më pak raste në Drejtortë Arsimore


Rajonale, Shërbimin Social Shtetëror, Zyrat e Punës, etj të cilat ofrojnë shërbimet e kërkuara nga telefonuesit. Më konkretisht, si në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm:

Njësia për mbrojtjen e fëmijëve	45
Policia e Rendit 129	29
Policia Bashkiake	1
Skuadrat e Terrenit për identifikimin e fëmijëve në situatë rruge	36
ASHMDF	45
Drejtoria Rajonale e Arsimit	5
Zyra Rajonale e Punësimit	1
Shërbimi Social Shtetëror	1
Shërbimi Psik-social në shkolla	4
Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza	2
Organizata të tjera joqeveritare	6
Qendra Kombëtare e Mirërritjes dhe Zhvillimit , Kombinat	3
<b>Total</b>	<b>178</b>



*Grafiku 4. Referimet tek shërbimet e specializuara gjatë 2016*

Nga 2010 deri në 2015 numri i referime ka patur një progres në rritje po ashtu edhe shumëllojshmëria e institucioneve të referuara, ku sipas të dhënave të Alo 116, 518 është numri i referimeve për këtë periudhë si dhe 178 përgjatë vitit 2016. Përgjatë këtyre viteve numri më i lartë i referimeve është bërë pranë NJMF-ve të NJQV, Policinë e rendit, Shërbime ligjore falas, Qendra shëndetsore dhe OJF të tjera të fushës. Më konkretisht si në grafikun e mëposhtëm:



Grafiku 5. Referimet tek shërbimet e specializuara në periudhën 2010-2015

Ajo çka vihet re në dy vitet e fundit në raport me vitet e mëparshme është një rritje e numrit të raportimeve dhe referimeve për fëmijët në situatë rruge, ku vetëm për 2016 numri i referimeve të bëra nga ALO 116 tek ASHMDF dhe Skuadrat e terrenit është 81 raste. Gjithashtu përgjatë viteve vihet re një rritje e numrit të referimeve tek institucionet shtetërore si NJMF, ASHMDF, Policia e Rendit dhe ajo bashkiake, SHSSH, DAR, Zyrat e Punës, etj kryesisht në 2015 dhe 2016 në raport me vitet e mëparshme ku numrin më të lartë të referimeve e zinin organizatat jo fitimprurëse.

### 2.3 Telefonata sipas shpërndarjes gjeografike

Lidhur me shpërndarjen gjeografike të telefonatave të marra nga Alo 116 përgjatë vitit 2016, ka një mbizotërim të telefonatave të pa identifikuar (15,880), ndjekur nga ato të zonave urbane të vendit (10671), kjo lidhet edhe me përqëndrimin më të lartë të popullatës në zonat urbane por edhe me njohjen më të madhe të linjës në zonat urbane. Më konkretisht si në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm:

Tel. sipas gjeografisë	Nr.
Tel. nga zona rurale	838
Tel. nga zona urbane	10671
Të pa identifikuara	15880
<b>Totali</b>	<b>27389</b>



Grafiku 6. Shpërndarja gjeografike e telefonatave


## 2.4 Mosha dhe gjinia e telefonuesve

Përsa i përket të dhënave demografike të telefonuesve, duhet theksuar se grupmosha mbizotëruese e cila ka kontaktuar ALO 116 përgjatë vitit 2016 është grupmosha e fëmijëve 13-15 vjeç, ku 2865 janë djem dhe 1319 vajza, ndjekur nga grupmosha 10-12 vjeç me 2120 djem dhe 1219 vajza dhe në nivele më të ulëta grupmoshat e tjera.

Një fluks i lartë i telefonatave të këtyre grupmoshave lidhen edhe me periudhën e adoleshencës, e cila korrespondon pikërisht në këtë moshë, ku çështjet të cilat lidhen me marrëdhëniet me bashkëmoshatarët, me prindërit dhe me gjininë tjetër kthehen në çështjet më shqetësuese për ta. Lidhur me gjininë e telefonuesve, ka një mbizotërim të gjinisë mashkullore në të gjitha grupmoshat të cilët kanë kontaktuar Alo 116, ku 14173 prej tyre janë djem dhe 6209 janë vajza.

Siç paraqitet dhe në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm është një numër i lartë i telefonuesve për të cilët nuk është identifikuar grupmosha apo që nuk kanë preferuar të japin informacion lidhur me moshën.

	Fëmijë			Të rritur			Fëmijë dhe të rritur /Të panjohur			Total		
	M	F	P	M	F	P	M	F	P	M	F	P
0 – 6	119	131	0	0	0	0	0	0	0	119	131	0
7 – 9	532	388	0	0	0	0	0	0	0	532	388	0
10 – 12	2120	1219	0	0	0	0	0	0	0	2120	1219	0
13-15	2865	1319	0	0	0	0	0	0	0	2865	1319	0
16 – 17	959	775	0	0	0	0	0	0	0	959	775	0
18+	337	332	0	361	132	0	0	0	0	698	464	0
E panjohur	7241	2045	75	622	383	2	93	49	5290	7956	2477	5367
<b>Totali</b>	<b>14173</b>	<b>6209</b>	<b>75</b>	<b>983</b>	<b>515</b>	<b>2</b>	<b>93</b>	<b>49</b>	<b>5290</b>	<b>15249</b>	<b>6773</b>	<b>5367</b>




Grafiku 7. Mosha dhe gjinia e telefonuesve

## 2.5 Rezidenca e fëmijës

Një informacion i rëndësishëm të cilit këshilluesit e Alo 116 i kushtojnë rëndësi gjatë telefonatave që marrin lidhet me faktin se me kë është duke qëndruar fëmija në momentin që kontakton Alo 116. Sipas të dhënave rezulton se fëmijët telefonojnë më shumë kur janë vetëm në shtëpi, 5266 djem dhe 3532 vajza, ndjekur nga telefonatat kur janë në shoqërinë e miqëve apo bashkëmoshatarëve në 6651 djem dhe 1397 vajza, dhe në nivele shumë më të ulta kur ata janë me familjen, kur janë në shkollë apo në rrugë. Më konkretisht, si në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm:

	Fëmijë			Të rritur			Fëmijë dhe të rritur panjohur /Të			Totali		
	Meshkuj	Femra	Të panjohur	M	F	P	M	F	P	M	F	P
<b>Me familjen</b>	581	578	0	63	97	0	0	0	2	644	675	<b>2</b>
<b>Familje e madhe</b>	18	24	0	4	5	0	0	0	0	22	29	<b>0</b>
<b>Është vetëm</b>	5266	3532	49	442	240	0	19	6	40	5727	3778	<b>89</b>
<b>Është me miqtë</b>	6472	1376	0	162	16	0	17	5	0	6651	1397	<b>0</b>
<b>Në rrugë</b>	574	123	0	79	102	0	13	9	1	666	234	<b>1</b>
<b>Strehëz</b>	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	1	<b>0</b>
<b>Institucion rezidencial</b>	0	1	0	0	1	0	0	0	0	0	2	<b>0</b>
<b>Në shkollë</b>	285	137	5	0	3	0	0	1	0	285	141	<b>5</b>
<b>Tjetër</b>	2	6	0	2	5	0	1	0	0	5	11	<b>0</b>
<b>E panjohur</b>	975	431	21	231	46	2	43	28	5247	1249	505	<b>5270</b>
<b>Total</b>	<b>14173</b>	<b>6209</b>	<b>75</b>	<b>983</b>	<b>515</b>	<b>2</b>	<b>93</b>	<b>49</b>	<b>5290</b>	<b>15249</b>	<b>6773</b>	<b>5367</b>



Grafiku 8. Rezidenca e fëmijës


## 2.6 Llojet e telefonatave të marra nga Alo 116

- *Telefonatat për Informacion*, ku kryesisht fëmijët telefonojnë për të kërkuar informacion mbi shërbimet e ALO 116, mbi stadet e zhvillimit të tyre, karakteristikat, pyetje lidhur me drogat duhanin dhe çështjet e HIV-AIDS-it, marrëdhëniet seksuale me partnerët, marrëdhëniet midis adoleshentëve apo marrëdhëniet me prindërit dhe mësuesit.
- *Telefonata për këshillim*, ku përfshihen telefonatat nëpërmjet të cilave ofrohet këshillim psiko-social ndaj fëmijëve, adoleshentëve dhe në pak raste të rinjve të moshës 18-21 vjeç. Tematikat më të zakonshme që referohen në këtë kategori telefonatash lidhen me marrëdhëniet me partnerin/en, problemet afektive, marrëdhëniet familjare, dhuna dhe abuzimi, fenomeni i bulizmit, problemet me mësuesit, problemet akademike, lypja, varësia nga substancat, problemet në përdorimin e internetit, etj.
- *Telefonatat për referim*, në këtë kategori klasifikohen ato telefonata të cilat kërkojnë ofrimin e shërbimeve specifike. Janë raste të cilat referohen për shërbime specifike në institucione si policia, NJMF, shërbimet shëndetësore, OJF të ndryshme të cilat ofrojnë shërbimet e kërkuara nga telefonuesit.
- *Telefonata për arsye "të tjera"*, i referohet telefonatave, qëllimi i të cilave nuk përmbushet nga ALO 116 ose të cilat nuk kanë nevojë për shërbime të ofruara nga Linja.
- *Telefonata testuese*, në të cilën përfshihen: telefonatat e heshtura (receptori është i hapur por personi nuk flet); telefonata në mjedise të larta me zhurmë ose mjedise me muzikë të lartë; telefonata tallëse dhe ofenduese, apo edhe ato telefonata ku shprehet nivel i lartë agresiviteti, përfshirë edhe ofendimet.

### 2.6.1 Telefonata për informacion

Telefonatat për informacion kanë zënë një numër të konsiderueshëm të telefonatave në linjën ALO 116 përgjatë periudhës Janar – Dhjetor 2016 me 6413 të tilla. Të ndara sipas kategorive të informacionit një numër të lartë zë informacion për ALO 116 (1316 djem dhe 991 vajza), informacion mbi Internetin e sigurtë (483 djem dhe 326 vajza), mbi çështjet e të drejtave të fëmijëve (154 djem dhe 121 vajza), etj. Një numër të lartë zë edhe kategoria e paspecifikuar apo çështje të tjera të ndryshme, më konkretisht si në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm:

	Fëmijë			Të rritur			Fëmijë dhe të rritur panjohur /Të			Totali		
	M	F	P	M	F	P	M	F	P	M	F	P
<b>Mbi linjën</b>	1316	991	0	49	44	0	0	0	0	1365	1035	0
<b>Mbi çështje të fëmijëve/ drejtat e fëmijëve</b>	154	121	0	4	22	0	0	0	0	158	143	0
<b>Faleminderit për ndihmën</b>	29	30	0	4	6	0	0	0	0	33	36	0
<b>Tel. pershendetse</b>	328	369	0	387	17	0	0	0	0	715	386	0
<b>Informacion mbi Internetin e Sigurt</b>	483	326	0	5	4	0	0	0	0	488	330	0
<b>E pa specifikuar/ tjetër</b>	1054	480	0	104	86	0	0	0	0	1158	566	0
<b>Total</b>	<b>3364</b>	<b>2317</b>	<b>0</b>	<b>553</b>	<b>179</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>3917</b>	<b>2496</b>	<b>0</b>



Grafiku 9. Telefonatat për informacion

Vihet re një ulje endjeshme e numrit të telefonatave për informacion nga viti në vit siç paraqitet edhe në tabelën e mëposhtme:


Viti	Nr. Telefonatat për informacion
2011	32,101
2012	26,397
2013	13,756
2014	6,377
2015	5,800
2016	6,413



## 2.6.2 Telefonata psiko-edukuese

Kategoria tjetër e telefonatave lidhet me telefonatat psiko-edukuese ku 2345 ishte numri i tyre për periudhën Janar-Djetor 2016 dhe grupmosha mbizotëruese ishte ajo e fëmijëve (1124 djem dhe 1054 vajza) dhe më pak të rriturit (75 burra dhe 92 gra).

	Fëmijë			Të rritur			Fëmijë dhe të rritur /Të panjohur			Totali		
	M	F	P	M	F	P	M	F	P	M	F	P
Psiko-edukim	1124	1054	0	75	92	0	0	0	0	1199	1146	0
Total	1124	1054	0	75	92	0	0	0	0	1199	1146	0




Grafiku 10. Telefonatat psiko-edukuese

## 2.6.3 Telefonata Testuese

Lidhur me kategorinë e telefonatave testuese ka një numër të lartë të tyre kryesisht nga grupmosha e fëmijëve ku mbizotërojnë telefonatat tallëse (5189 djem dhe 1285 vajza), mbyllje telefonate (1422 djem dhe 595 vajza), sharje (926 djem dhe 69 vajza), ofendime (267 djem dhe 69 vajza) dhe në nivele më të ulëta kërcënimet, muzikë, etj.

	Fëmijë			Të rritur			Fëmijë dhe të rritur /Të panjohur			Totali		
	M	F	p	M	F	P	M	F	P	M	F	P
Ofendim	267	22	0	5	0	0	0	0	1	272	22	1
Sharje	926	69	0	17	2	0	0	0	2	943	71	2
Tallje	5189	1285	27	163	8	1	44	6	3	5396	1299	31
Kërcënim	2	0	0	1	0	0	0	0	0	3	0	0
Zhurme	381	94	20	7	3	1	6	1	168	394	98	189
Mbyllje	1422	595	25	60	19	1	27	16	1284	1509	630	1310

<b>Muzikë</b>	72	19	6	2	0	0	0	0	114	74	19	<b>120</b>
<b>Totali</b>	<b>8259</b>	<b>2084</b>	<b>78</b>	<b>255</b>	<b>32</b>	<b>3</b>	<b>77</b>	<b>23</b>	<b>1572</b>	<b>8591</b>	<b>2139</b>	<b>1653</b>



Grafiku 11. Telefonatat testuese


## 3 KATEGORIZIMI I RASTEVE SIPAS ÇËSHTJEVE TË RAPORTUARA

Siç është theksuar edhe më lart, çështjet e raportuara gjatë vitit 2016 në Linjën Kombëtare të Këshillimit për fëmijë janë të ndryshme dhe lidhen me abuzimin, shfrytëzimin e fëmijëve, marrëdhëniet mes bashkëmoshatarëve, problemet në shkollë, çështjet lidhore, abuzimi me substancat, çështje që lidhen me aftësinë ndryshe, seksualitetin, marrëdhëniet familjare, shëndetin mendor, problemet shëndetësore dhe diskriminimin.

### 3.1 Abuzim dhe dhunë

Një nga çështjet shqetësuese për grupmoshën e fëmijëve janë çështjet e abuzimit, ku në rastet e raportuara dominon bullizimi (15 djem dhe 4 vajza), abuzimi fizik (13 djem dhe 3 vajza), abuzimi emocional (2 djem dhe 10 vajza) dhe në nivele më të ulëta raportime mbi dhunën në familje, neglizhencën dhe abuzimin seksual. Më konkretisht si në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm:

	Fëmijë			I rritur			Fëmijë dhe të rritur panjohur /Të			Totali		
	M	F	P	M	F	P	M	F	P	M	F	P
<b>Abuzim Seksual</b>	0	2	0	0	0	0	0	0	0	0	2	0
<b>Abuzim Fizik</b>	13	3	0	0	1	0	0	0	0	13	4	0
<b>Abuzim Emocional</b>	2	10	0	0	1	0	0	0	0	2	11	0
<b>Neglizhencë</b>	1	2	0	0	0	0	0	0	0	1	2	0
<b>Dëshmitar dhune</b>	1	2	0	0	1	0	0	0	0	1	3	0
<b>Bulizëm</b>	15	4	0	0	0	0	0	0	0	15	4	0
<b>Dhunë në Familje</b>	3	0	0	0	1	0	0	0	0	3	1	0
<b>E pa specifikuar/ tj</b>	2	0	0	0	0	0	0	0	0	2	0	0
<b>Totali</b>	<b>37</b>	<b>23</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>4</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>37</b>	<b>27</b>	<b>0</b>




Grafiku 12. Rastet e abuzimit dhe dhunës

Nga rastet e abuzimit të raportuar nga fëmijët, abuzuesit kryesisht janë në mjedisin familjar, për vajzat në 8 raste dhunuesi ka qënë babi, në 6 raste nëna dhe për djemtë në 5 raste babai dhe në 2 raste nëna. Janë raportuar si abuzues mësuesit në 14 raste nga djemtë dhe në 2 raste nga vajzat si edhe bashkëmoshatarët në 17 raste për djemtë dhe në 5 raste nga vajzat.

Ka një ulje të rasteve të abuzimit të raportuara nga viti në vit pranë Alo 116 si në tabelën dhe garfikun e mëposhtëm:


Viti	Nr. i rasteve të Abuzimit
2010	290
2011	192
2012	160
2013	68
2014	27
2015	35
2016	64



Grafiku 13. Rastet e abuzimit dhe dhunës nga 2010-2016

### 3.2 Shfrytëzimi i fëmijës

Lidhur me shfrytëzimin e fëmijëve apo përdorimin e tyre për lypje ka patur një raportim të lartë kryesisht nga të rriturit përgjatë 2016, ku në 99 raste kanë qënë vajza dhe gra ato që kanë raportuar dhe në 15 raste djemtë dhe burrat. Sipas të dhënave të stafit të ALO 116, pothuajse të gjitha rastet e fëmijëve në situatë rruge janë raportuar nga qytetarë dhe kalimtarë të rastit të cilët kanë zgjedhur të denoncojnë nëpërmjet ALO 116 111.




Grafiku 14. Fëmijët të përdorur për lypje

Problematika të tjera të raportuara gjatë 2016 në Linjën e këshillimit për fëmijë kanë qënë kërkimi i strehës nga grupmosha e të rriturve në 2 raste, 4 raste të fëmijëve të humbur, dhe kërkesa për ndihmë financiare dhe materiale (11gra dhe vajza nga të rriturit dhe nga fëmijët 3 djem dhe 2 vajza).

### 3.3 Marrëdhëniet mes bashkëmoshatarëve

Siç është theksuar edhe më lart, një nga çështjet e raportuara më së shumti në linjën e këshillimit përgjatë 2016 lidhet me marrëdhëniet me bashkëmoshatarët. Më specifikisht, çështje që lidhen me problemet me miqtë dhe bashkëmoshatarët kanë raportuar 55 djem dhe 79 vajza, marrëdhëniet afektive (20 djem dhe 59 vajza), probleme me partnerin/ren (8 djem dhe 17 vajza), etj. Më konkretisht:


	Fëmijë			Të rritur			Fëmijë dhe të rritur /Të panjohur			Totali		
	M	F	P	M	F	P	M	F	P	M	F	P
Probleme me miqtë	55	79	0	0	0	0	0	0	0	55	79	0
Probleme me partnerin/en	8	17	0	0	0	0	0	0	0	8	17	0
Marredhenie afektive	20	59	0	3	0	0	0	0	0	23	59	0
E pa specifikuar/ tjetër	1	2	0	0	0	0	0	0	0	1	2	0
<b>Totali</b>	<b>84</b>	<b>157</b>	<b>0</b>	<b>3</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>87</b>	<b>157</b>	<b>0</b>



Grafiku 15. Marrëdhëniet midis bashkëmoshatarëve

Ndër vite numri i telefonatave të cilat raportojnë probleme me bashkëmoshatarët ka qënë i ndryshëm dhe në rënie kryesisht në 4 vitet e fundit, viti 2011 ka patur numrin më të lartë të telefonatave ku raportohen problematikat që lidhen me bashkëmoshatarët dhe më pak viti 2014 me 107 raste, më konkretisht si në tabelën e mëposhtme:

Viti	Probleme me bashkëmoshatarët
2010	617
2011	1327
2012	705
2013	308
2014	107
2015	120
2016	244




Grafiku 16. Marrdhëniet midis bashkëmoshatarëve ndër vite

### 3.4 Probleme në shkollë

Problematikat lidhur me shkollën duket se janë çështje të cilat shqetësojnë më së shumti grupmoshën e fëmijëve dhe lidhen kryesisht me problemet me mësuesit (12 djem dhe 6 vajza), probleme akademike (10 djem dhe 7 vajza) dhe çështje të ankthit që lidhen me performancën (13 djem dhe 8 vajza).

	Fëmijë			Të rritur			Fëmijë dhe të rritur /Të panjohur			Totali		
	M	F	P	M	F	P	M	F	P	M	F	P
Probleme me mësuesit	12	6	0	0	0	0	0	0	0	12	6	0
Probleme të tjera që lidhen me të rriturit.	1	1	0	0	0	0	0	0	0	1	1	0
Probleme akademike	10	7	0	0	0	0	0	0	0	10	7	0
Ankthi i performances	13	8	0	0	0	0	0	0	0	13	8	0
Braktisja e shkollës	1	0	0	0	0	0	0	0	0	1	0	0
E pa specifikuar/tjetër	2	1	0	0	0	0	0	0	0	2	1	0
<b>Totali</b>	<b>39</b>	<b>23</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>39</b>	<b>23</b>	<b>0</b>




Grafiku 17. Probleme në shkollë në 2016

Problematikat të cilat lidhen me shkollën ka qënë një nga kategoritë më të hasura në linjën e këshillimit për fëmijë përgjatë viteve e cila po ashtu ka një rënie të numrit në 4 vitet e fundit. Më konkretisht si në tabelën e mëposhtme:




Viti	Probleme në shkollë
2010	276
2011	361
2012	209
2013	60
2014	33
2015	61
2016	62



Grafiku 18. Probleme në shkollë 2010-2016

### 3.5 Çështjet Ligjore

Gjatë 2016 numri i çështjeve ligjore ka qënë i ulët krahasuar me vitet e mëparshme ku vetëm 3 të rritur kanë kontaktuar Alo 116 për këshillimin dhe informim mbi çështjet ligjore.




Grafiku 19. Çështjet ligjore

### 3.6 Përdorimi dhe abuzimi me substancat

Çështje të tjera të rëndësishme të raportuar nga fëmijët përgjatë 2016 lidhen me varësinë nga substancat të raportuara në 24 raste nga djemtë dhe në 2 raste nga vajzat si edhe informacion mbi substancat në 2 raste.

	Fëmijë			I rritur			Fëmijë dhe të rritur /Të panjohur			Totali		
	M	F	P	M	F	P	M	F	P	M	F	P
<b>Informacion mbi substancat</b>	6	0	0	0	0	0	0	0	0	6	0	0
<b>Varësi</b>	24	2	0	0	0	0	0	0	0	24	2	0
<b>E pa specifikuar/</b>	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
<b>Totali</b>	<b>30</b>	<b>2</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>30</b>	<b>2</b>	<b>0</b>




Grafiku 20. Abuzimi me substancat

### 3.7 Seksualiteti

Çështjet e lidhura me informacionin mbi seksualitetin, shtatzaninë, masturbimin, kontaktet e para seksuale janë disa nga çështjet që shqetësojnë grupmoshën e fëmijëve dhe për të cilat kërkojnë informacion. Përgjatë 2016 janë regjistruar telefonata nga fëmijët të cilët kërkojnë informacion mbi seksualitetin dhe fakte të jetës (4 djem dhe 3 vajza), kontaktet seksuale (6 djem), masturbimin (4 djem), shtatzaninë (1 djalë dhe 1 vajzë), etj.

	Fëmijë			Të rritur			Fëmijë dhe të rritur /Të panjohur			Totali		
	M	F	P	M	F	P	M	F	P	M	F	P
<b>Informacion mbi seksualitetin dhe fakte te jetës.</b>	4	3	0	0	0	0	0	0	0	4	3	0
	1	1	0	0	0	0	0	0	0	1	1	0

Shtatzani												
STIs /STDs	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Masturbim	4	0	0	0	0	0	0	0	0	4	0	0
Fantazi seksuale	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Kontakte seksuale	6	0	0	0	0	0	0	0	0	6	0	0
E pa specifikuar/ tjetër	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	1	0
<b>Totali</b>	<b>15</b>	<b>5</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>15</b>	<b>5</b>	<b>0</b>




Grafiku 21. Seksualiteti

### 3.8 Marrëdhëniet familjare

Marrëdhëniet me familjarët vazhdon të mbeten një ndër shqetësimet kryesore në periudhën e adoleshencës, ku gjatë janë raportuar pranë Alo 116 çështje të cilat lidhen kryesisht me marrëdhëniet prind- fëmijë (9 djem dhe 33 vajza), mbi marrëdhëniet vëllazërore (6 djem dhe 2 vajza), çështje të cilat lidhen me divorcin e prindërve 8 djem dhe 8 vajza), humbje të të afërmeve (3 vajza), etj.

	Fëmijë			Të rritur			Fëmijë dhe të rritur /Të panjohur			Totali		
	M	F	P	M	F	P	M	F	P	M	F	P
<b>Prindër të divorcuar/të</b>	8	8	0	0	0	0	0	0	0	8	8	0

<b>ndarë/ose në konflikt</b>												
<b>Kujdestaria e fëmijës</b>	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
<b>Mirëmbajtja dhe përkrahja e fëmijës</b>	2	5	0	0	0	0	0	0	0	2	5	0
<b>Mardhëniet prind-fëmijë</b>	9	33	0	0	1	0	0	0	0	9	34	0
<b>Mardhënia vllazërore</b>	6	2	0	0	1	0	0	0	0	6	3	0
<b>Familje e re /familje mikes</b>	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
<b>Humbje e madhe /zi</b>	0	3	0	0	0	0	0	0	0	0	3	0
<b>Çështje të adoptimit</b>	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
<b>Prindër abuzues me substanca/ me probleme të shëndetit mendor</b>	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
<b>E pa specifikuar/ tjetër</b>	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
<b>Totali</b>	<b>25</b>	<b>51</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>2</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>25</b>	<b>53</b>	<b>0</b>




Grafiku 22. Marrëdhëniet familjare

Çështjet të cilat lidhen me marrëdhëniet familjare si divorci i prindërve, dhunë në familje, marrëdhëniet vëllazërore dhe prindërore konfliktuale, etj janë çështje të cilat kanë patur një numër të lartë të raportimeve në Alo 116 përgjatë viteve 2010-2013 dhe kanë pësuar një

ulje në vitet e fundit, ku në 2015 vetëm 55 raste kanë raportuar problematika të lidhura me marrëdhëniet familjare.

Viti	Marrëdhëniet familjare
2010	981
2011	611
2012	345
2013	21
2014	87
2015	55
2016	78




Grafiku 23. Rastet e marrëdhënieve familjare 2010-2016

### 3.9 Shëndeti Mendor

Çështjet e shëndetit mendor janë një kategori tjetër e telefonatave të raportuara përgjatë 2016 në Linjën e këshillimit për fëmijë, ku mbizotërojnë mërzitja (7 djem dhe 9 vajza), frika dhe ankthi (6 djem dhe 3 vajza), mungesa e besimit (2 djem dhe 2 vajza) dhe çështje që lidhen me pamjen e jashtme fizike, etj.

	Fëmijë			Të rritur			Fëmijë dhe të rritur panjohur			Totali		
	M	F	P	M	F	P	M	F	P	M	F	P
<b>Mërzitje</b>	7	9	0	0	0	0	0	0	0	7	9	0

<b>Pamja trupore/ fizike</b>	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	1	0
<b>Vetmi</b>	0	2	0	0	0	0	0	0	0	0	2	0
<b>Mungesë besimi</b>	2	2	0	0	0	0	0	0	0	2	2	0
<b>Çrregullime të të ngrënit</b>	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
<b>Frikë dhe ankth</b>	6	3	0	0	0	0	0	0	0	6	3	0
<b>Depresion</b>	0	0	0	0	1	0	0	0	0	0	1	0
<b>Identiteti dhe qëllimet e jetës</b>	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
<b>Fobi /obsesion</b>	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
<b>Vetëdëmtim</b>	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
<b>Vetëvrasje</b>	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
<b>E pa specifikuar/ tjetër</b>	2	2	0	0	0	0	0	0	0	2	2	0
<b>Totali</b>	<b>17</b>	<b>19</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>1</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>17</b>	<b>20</b>	<b>0</b>



Grafiku 24. Shëndeti mendor


Lidhur me rastet të cilët telefonojnë për çështje shëndetësore, numri i këtyre rasteve është i ulët, Përgjatë 2016 ka patur vetëm 4 telefonata nga fëmijët të cilët kanë raportuar shqetësime mbi sëmundje dhe vetëm një i rritur.

### 3.10 Siguria në internet

Siguria në internet apo çështje të cilat lidhen me aksesin në internet është një çështje e cila shqetëson fëmijët vitet e fundit, ku përgjatë 2016 janë marë telefonata lidhur me lundrimin e pa sigurtë në faqe të ndryshme në internet nga 46 fëmijë (26 djem dhe 20 vajza),

telefonata lidhur me bullizmin kibernetik (cyber bullying) nga 4 djem dhe 9 vajza, varësia nga rrjetet sociale (2 djem dhe 1 vajzë), postime të papërshtatshme në faqe të ndryshme (2 djem dhe 2 vajza), etj. Më konkretisht, panorama e telefonatave mbi internetin e pasigurtë paraqitet si mëposhtë:

	Fëmijë			Të rritur			Fëmijë dhe të rritur panjohur			Totali		
	Me	F	P	M	F	P	M	F	P	M	F	P
Lundrimi i pasigurt ne internet	26	20	0	0	0	0	0	0	0	26	20	0
Cyber bullying	4	9	0	0	1	0	0	0	0	4	10	0
Mobile bullying	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Pornografi te rritur ne internet (adresa?)	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Pornografi me femije ose te rinj (Raportim urgjent i adreses)	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Grooming	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Lojra online	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	1	0
Varesi nga rrjetet sociale ose interneti	2	1	0	0	0	0	0	0	0	2	1	0
SMS ose Postime me permbajtje te papershtatshme	2	2	0	0	0	0	0	0	0	2	2	0
<b>Totali</b>	<b>34</b>	<b>33</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>1</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>34</b>	<b>34</b>	<b>0</b>



Grafiku 25. Siguria në internet

Telefonatat lidhur me diskriminimin kanë patur një ulje të ndjeshme gjatë vitit 2016 krahasuar me vitet e mëparshme. Në total janë marrë vetëm 3 telefonata, të lidhura me paragjykimin dhe racizmin.

## 4. KONKLUZIONE

Linja kombëtare e këshillimit për fëmijë është një shërbim falas 24 orë në 24, në shtatë ditë të javës dhe ofron shërbime të tilla si Këshillim Psikologjik; Informacion dhe Referim në shërbimet përkatëse sipas specifikave të rasteve.

Përgjatë periudhës 2010-2016 numri total i telefonatave pranë Alo 116 është 521,389 ku pjesën më të madhe të këtyre telefonatave e zënë telefonatat nga grupmosha 13-15 vjeç që përkon edhe me periudhën e adoleshencës.

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2016 ALO 116 ka pritur në total 27,389 telefonata të cilat 23 % e tyre janë telefonata për informacion, 9 % telefonata psiko-edukuese, 3 % telefonata për këshillim, 7 % telefonata të ndërprera, 45 % telefonata testuese dhe 13 % telefonata në të cilat telefonuesi nuk flet (heshtje).

Nga rastet e trajtuara gjatë vitit 2016, një numër të lartë zënë rastet të cilat raportojnë problematika të marrëdhënieve mes bashkëmoshatarëve, të shfrytëzimit për arsye përfitimi, marrëdhëniet familjare, problematikat në shkollë, siguria në internet, etj dhe në nivele më të ulëta çështjet të cilat lidhen me çështjet ligjore, diskriminimi, shëndeti fizik dhe çështjet e aftësive të veçanta, etj.

Në dy vitet e fundit në raport me vitet e mëparshme vihet re një rritje e numrit të raportimeve dhe referimeve për fëmijët në situatë rruge, ku vetëm për 2016 numri i referimeve të bëra nga ALO 116 tek ASHMDF dhe Skuadrat e terrenit është 81 raste.

Përgjatë viteve ka një rritje të numrit të referimeve tek institucionet shtetërore si NJMF, ASHMDF, Policia e Rendit dhe ajo bashkiake, SHSSH, DAR, Zyrat e Punës, etj. kryesisht në 2015 dhe 2016 në raport me vitet e mëparshme ku numrin më të lartë të referimeve e zinin organizatat jo fitimprurëse;

Grupmosha mbizotëruese e cila ka kontaktuar ALO 116 përgjatë vitit 2016 është grupmosha e fëmijëve 13-15 vjeç me 2865 djem dhe 1319 vajza, ndjekur nga grupmosha 10-12 vjeç me 2120 djem dhe 1219 djem dhe më nivele më të ulëta grumoshat e tjera.

Telefonatat për informacion kanë zënë një numër të konsiderueshëm të telefonatave në linjën ALO 116 përgjatë periudhës Janar – Dhjetor 2016 me 6413 të tilla. Të ndara sipas kategorive të informacionit një numër të lartë zënë telefonatat të cilat kërkojnë informacion për ALO 116 (1316 djem dhe 991 vajza), informacion mbi internetin e sigurtë (483 djem dhe 326 vajza), mbi çështjet e të drejtave të fëmijëve (154 djem dhe 121 vajza), etj.

Telefonatat psiko-edukuese zënë një numër të lartë gjatë 2016. 2345 ishte numri i tyre për periudhën Janar-Djetor 2016 ku grupmosha mbizotëruese është grupmosha e fëmijëve (1124 djem dhe 1054 vajza) dhe më pak të rriturit (75 burra dhe 92 gra).



Një nga çështjet shqetësuese për grupmoshën e fëmijëve janë çështjet e abuzimit, ku nga kategoritë e dhunës janë raportuar bullizimi (15 djem dhe 4 vajza), abuzimi fizik ( 13 djem dhe 3 vajza, abuzimi emocional ( 2 djem dhe 10 vajza) dhe në nivele më të ulëta raportime mbi dhunën në familje, neglizhencën dhe abuzimin seksual.

Lidhur me shfrytëzimin e fëmijëve apo përdorimin e tyre për lypje, ka patur një raportim të lartë kryesisht nga të rriturit përgjatë 2016, 99 raste kanë qënë vajza dhe gra ato që kanë raportuar dhe në 15 raste djemtë dhe burrat.

Problemi i marrëdhënieve me bashkëmoshatarët është një çështjet e raportuara më së shumti në linjën e këshillimit përgjatë 2016, ku çështjet që lidhen me problemet me miqtë janë raportuar, marrëdhëniet afektive, probleme me partnerin/ren, etj.

Problematikat lidhur me shkollën të raportuara nga fëmijët, lidhen kryesisht me problemet me mësuesit, problemet akademike apo të arritjeve në shkollë dhe çështje të ankthit që lidhen me performancën.

Telefonatat të cilat kanë patur në fokus çështjet e abuzimit me substancat lidhen me varësinë nga substancat të raporuara në 24 raste nga djemtë dhe në 2 raste nga vajzat si edhe informacion mbi substancat në 2 raste.

Seksualiteti mbetet një çështje ku adoleshentët kërkojnë informacion dhe Përgjatë 2016 janë regjistruar telefonata nga fëmijët të cilët kërkojnë informacion mbi seksualitetin dhe fakte të jetës, kontaktet seksuale, masturbimin shtatzaninë, etj.

Marrëdhëniet me familjarët. Grupmosha e fëmijëve ka raportuar pranë Alo 116 çështje të cilat lidhen kryesisht me marrëdhëniet prind- fëmijë, mbi marrëdhëniet vëllazërore, çështje të cilat lidhen me divorcin e prindërve, humbje të të afërmëve etj.

Siguria në internet apo çështje të cilat lidhen me aksesin në internet është një çështje e cila shqetëson fëmijët vitet e fundit dhe kanë patur një rritje edhe gjatë 2016, të cilat janë telefonata të lidhura me lundrimin e pa sigurtë në faqe të ndryshme në internet, telefonata lidhur me bullizmin kibernetik (cyber bullying), varesia nga rrjetet sociale, postime të papërshtatshme në faqe të ndryshme, etj.

## 5. REKOMANDIME

Vazhdimësia e mbështetjes financiare e ALO 116 nga shteti dhe donator të ndryshëm si një ndër aktorët kryesorë në identifikimin dhe referimin e rasteve, nisur nga numri i lartë i telefonatave dhe rasteve të trajtuara ndër vite si edhe në kuadër të zbatimit të politikave dhe strategjive për mbrojtjen e fëmijëve të miratuara nga shteti shqiptarë.

Me ndryshimet administrative - territorial të vitit 2015, miratimin e ligjit të ri për vetqeverisjen vendore, ligjin e shërbimeve shoqërore dhe atë të mbrojtjes së fëmijëve, ALO 116 duhet të vazhdojë të jetë një partner apo portë hyrëse e identifikimit të rasteve në nivel kombëtar për ofrimin e shërbimeve edhe në nivel vendor në kushtet ku NJQV hasen me burime njerzore dhe financiare të limituara;

Nënshkrimin e marrveshtjeve të bashkëpunimit midis ALO 116 dhe NJQV të reja për një koordinim më të mirë dhe në kohë të trajtimit të rasteve dhe si kontribues kryesorë në krijimin dhe funksionimin e sistemeve të efektshme për mbrojtjen e fëmijëve në nivel vendor;

Fuqizimin e rolit të ALO116 në identifikimin dhe trajtimin e rasteve të fëmijëve në situatë rruge në kuadër të zbatimit Planit Kombëtar të Veprimit për Mbrojtjen e fëmijëve në situatë rruge si dhe zbatimin e planeve lokale për fëmijët në situatë rruge, duke konsideruar numrin e lartë të raportimeve pranë ALO 116 në dy vitet e fundit;

Fuqizimin e mëtejshëm të rolit të ALO 116 në evidentimin e rasteve emergjente në çdo orë të ditës si një ndër shërbimet 24 orëshe në shtatë ditë të javës, në kushtet kur NJMF operojnë me orare të kufizuara;

Rekomandohet që ALO 116 të rifreskojë database-in e kontakteve të shërbimeve publike dhe jo publike të cilat ofrojnë shërbime të larmishme, si mbështetje psiko-sociale në nivel komunitar, mbështetje ligjore, formim profesional, etj për një adresim efektiv të rasteve duke konsideruar faktin që pranë ALO 116 raportohen një llojshmëri nevojash të lidhura me mbrojtjen e fëmijëve por jo vetëm.

**ALO 116-Linja Kombëtare e Këshillimit për Fëmijë është një shërbim pa pagesë për fëmijët 24/24 çdo ditë të javës I cili ofron:**

- Dëgjim aktiv të fëmijëve
- Këshillim psikologjik
- Informacion për të drejtat e fëmijëve dhe të rinjve
- Referim në shërbimet përkatëse sipas specifikës së rastit.

Ky shërbim përqëndrohet tek fëmijët në nevojë si: fëmijët e dhunuar, abuzuar apo keqtrajtuar, fëmijët e rrugës, fëmijët që shfrytëzohen në punë, fëmijët që janë në konflikt me ligjin etj. Ky shërbim nuk përjashton as prindërit, mësuesit, edukatorët apo personat që punojnë me fëmijët dhe personat e intersuar për çështje lidhur me dhe për fëmijët.

Me 19 tetor 2012, ALO 116 u bë anëtare me të drejta të plota e Linjës Ndërkombëtare të Këshillimit për Fëmijë (CHI ) si një mundësi për të sjellë zërin e fëmijëve shqiptarë sëbashku me zërin e fëmijëve nga Europa dhe bota.

**ALO 116 mbështetet dhe financohet nga :**



**dhe të gjitha kompanitë e telefonisë në Shqipëri:**

